



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 385 Akti

Nr. 373 Vendimi
Tiranë, më 23.4.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Pamela Qirko	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në datën 21.4.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore në lidhje me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ilir Përdeda**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH-së”;

Ligji 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, analizoi provat shkresore si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Përdeda, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, është subjekt që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 3, pika 7 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) më 16.12.2019 zhvilloi procedurat e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Alma Faskaj dhe Lulzim Hamitaj. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere, znj. Alma Faskaj.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 16.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesues komisioneri Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ilir Përdeda.
5. Subjekti i rivlerësimit, gjithashtu deklaroi¹ mospasjen e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupit gjykues.
6. Me vendimin nr. 61, datë 5.10.2020 të Komisionit, për shkaqe të arsyeshme, u vendos zëvendësimi i relatores së çështjes, komisioneres Alma Faskaj me anëtarin tjetër, komisioneren Pamela Qirko. Relatorja e çështjes, znj. Qirko, deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
7. Bazuar në kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor për shqyrtimin me përparësi të subjektit të rivlerësimit, Komisioni menjëherë administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse për kryerjen e procesit të rivlerësimit: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), i hartuar sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë dhe konfliktit të interesave; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), i hartuar sipas neneve 35 – 39 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kontrollin e figurës; dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGJ”), i hartuar sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale.
8. Pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet ndihmëse, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me të tria kriteret, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.
9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit mbi të tria kriteret, në datën 8.4.2021, vendosi: i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret² për subjektin e rivlerësimit; ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime

¹ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, dërguar nëpërmjet postës elektronike të datës 27.4.2020.

² Vlerësimin të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimin të aftësive profesionale.

të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me kriterin profesional, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

10. Në datën 8.4.2021, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: i) rezultatet e hetimit kryesisht; ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; iii) të drejtën e njohjes me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative; iv) të drejtën për të paraqitur prova të reja ose thirrjen e dëshmitarëve në kuptim të barrës së provës, si dhe të drejtën për të paraqitur shpjegime deri në datën 18.4.2021. Subjekti mori dijeni në lidhje me rezultatet e hetimit, si dhe të drejtën e njohjes me provat e administruara gjatë hetimit administrativ edhe pse nuk e ushtroi atë.

11. Në datën 14.4.2020, subjekti rivlerësimit, me anë të postës elektronike, dërgoi shpjegimet dhe provat e tij në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ.

12. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, me vendimin e datës 16.4.2021, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në datën 21.4.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë. Për këtë, subjekti u njoftua nga relatori i çështjes nëpërmjet postës elektronike³.

13. Pas mbylljes së hetimit dhe njoftimit të subjektit për zhvillimin e seancës dëgjimore, në datën 19.4.2021 mbërriti në adresë të Komisionit⁴ një denoncim⁵ ndaj subjektit të rivlerësimit.

14. Trupi gjykues, pas administrimit dhe vlerësimit të denoncimit e ftoi subjektin⁶ që të japë shpjegime në seancën dëgjimore të datës 21.4.2021.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Në datën 21.4.2021 u zhvillua seanca dëgjimore në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Steven Kessler, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

16. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe mbi ato për të cilat ishte kaluar barrë prove, përfshirë dhe të drejtën për shpjegime mbi disa denoncime.

17. Z. Ilir Përdeda, pasi dëgjoi fjalën e relatorit, mori kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, si dhe shpjegimet lidhur me gjetjet e hetimit administrativ. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, kërkoi konfirmimin në detyrë.

18. Seanca dëgjimore e datës 21.4.2020 u ndërpre, për të rifilluar në datën 23.4.2021, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Z. Ilir Përdeda ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin

³ Dërguar në datën 16.4.2021 ora 4.41 p.m.

⁴ modeldenoncimi@kpk.al

⁵ Denoncim i shtetasit N. Gj.

⁶ Nëpërmjet postës elektronike të datës 20.4.2021.

e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21. Ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit, parime këto, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në këtë ligj përcaktohet angazhimi i organeve kompetente ndihmëse në procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

21.1. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në përfundim të të cilit paraqet një raport të hollësishëm me konstatimet përkatëse.

21.2. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës, në përfundim të të cilit konstaton përshatshmërinë apo papërshatshmërinë e subjekti të rivlerësimit.

21.3. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, KLGJ-ja është organi kompetent për vlerësimin profesional, mbi bazën e tri dokumenteve ligjore, të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe duke konsideruar edhe burimet arkivore në lidhje me ankesat ndaj subjektit të rivlerësimit.

22. Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁷ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; dh) raportin e kontrollit të figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; ë) denoncimet e publikut; dhe f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

24. Bazuar në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është verifikimi i deklaramit dhe kontrollit të pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit, i përmbushjes së

⁷ 41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

detyrimeve financiare, përfshirë edhe interesat privatë për subjektin e rivlerësimit, si dhe personave të lidhur me të.

A.1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

25. ILDKPKI-ja, si organ kompetent ndihmës, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI, në vitin 2003, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

26. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë nga viti 2003 deri në vitin 2016, si dhe në datën 28.1.2017 ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, “Vetting”, referuar ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ILDKPKI-ja, ka konstatuar për subjektin e rivlerësimit se:

- (a) ka pasaktësi në deklaratat e interesave private ndër vite;
- (b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- (d) nuk ka kryer deklarim të rremë; dhe
- (e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A.2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

27. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja, Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, në përputhje me ligjin nr. 84/2016. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive, në verifikimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim dhe verifikimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave.

28. Në deklaratën “Vetting”, të dorëzuar në ILDKPKI më 28.1.2017, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme:

29. Apartament banimi me sipërfaqe 83 m², i ndodhur në ***** të qytetit R****⁸, *****, *****, *****, me numër pasurie *****, zona kadastrale ***, volum **, faqe ***, indeks harte *****, i blerë nëpërmjet privatizimit nga ish-Ndërmarrja Komunale Banesa Mirditë, në datën 12.5.1993, sipas kontratës së shitjes nr. ***** të Zyrës së Noterisë Mirditë, blerë nga babai N.P., me cilësinë e përfaqësuesit të familjes. Zotëron 33.33%. Vlera 17.666 lekë.

29.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar të ardhurat nga pensioni i babait dhe paga e nënës.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite:

⁸ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneksi 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së): vërtetim datë 11.10.2016, nga ZVRPP-ja Mirditë, me anë të cilës vërtetohet se N., O. dhe Ilir Përdeda kanë të regjistruar një apartament me sip. 83 m² në qytetin e R****ut, në zonën kadastrale *****, me nr. pasurie *****, me indeks harte *** dhe adresë: pall. **, shk. ***, ap. nr. ***, ii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 12.5.1993 me palë shitëse Ndërmarrja Komunale Banesa Mirditë dhe palë blerëse N. P., të apartamentit 2+1 me nr. ***, pall. ***, në vlerën 17.666 lekë. Kartelë e pasurisë së paluajtshme, në të cilën Ilir Përdeda është bashkëpronar me 1/3 pjesë; iii) vërtetim për bazën e vlerësueshme, ISSH, me punëdhënëse Uzina e Bakrit R****, në emër të O. P., për periudhën 1.11.1993 - 31.12.1993, vlera 7.400 lekë; iv) vërtetim për bazën e vlerësueshme, ISSH, me punëdhënëse Uzina e Bakrit R****, në emër të O. P., për periudhën 1.1.1994 - 30.6.1997; v) vërtetim për vjetërsinë në punë, në emër të O. P., nga data 10.8.1968 - 15.7.2000, vlera 178.003 lekë; vi) vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016 nga ISSH-ja, e cila vërteton se N. P. ka përfituruar pension invalidi për periudhën nga 1.11.1988 - 31.12.1994, vlera 115.124 lekë..

29.2. Në deklaratën periodike vjetore (në vijim “DPV”) të vitit 2003, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar pasurinë në bashkëpronësi, në pjesën takuese 33,3 %, e privatizuar në vitin 1992. Subjekti e ka deklaruar rregullisht këtë pasuri si adresë banimi në DPV-të 2003-2016.

A.2.1. Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri dhe burimet e krijimit

29.3. Me qëllim verifikimin e deklaramit të kryer nga subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin e përfituar nga procesi i kontrollit të pasurive në ILDKPKI, si dhe gjithashtu ka kryer një hetim të pavarur⁹ drejtuar institucioneve kompetente publike dhe private, në përfundim të të cilit u konstatua se:

29.4. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mirditë (aktualisht “ASHK”)¹⁰ ka informuar se subjekti është bashkëpronar në pasurinë nr. ***, volum ***, faqe ***, me sipërfaqe 83 m², apartament, zona kadastrale ***, qyteti R***.

29.5. Nga administrimi i dokumentacionit depozituar në ASHK rezultoi se pasuria është përfituar nëpërmjet privatizimit, sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, i ndryshuar. Në datën 12.05.1993 është lidhur para noterit publik kontrata e shitblerjes midis shtetasit N. P. (babai i subjektit) dhe Ndërmarrjes Komonale Banesa Mirditë, për shitjen e apartamentit nr. ***, pall. ***, shk. ***, kati ***, ***, kundrejt çmimit 17,666 lekë, çmim i cili sipas kontratës është shlyer sipas mandatpagesës nr. ***, datë 28.4.1993.

29.5.1. Kontrata është lidhur me bazë përbërjen familjare të datës 1.12.1992¹¹, referuar certifikatës së gjendjes civile, depozituar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, me kryefamiljar babain e subjektit dhe personat e tjerë madhorë të familjes, nëna e subjektit dhe subjekti i rivlerësimit, mbi bazën e së cilës është kryer dhe regjistrimi në regjistrin e pasurive të paluajtshme¹².

29.6. Nga hetimi i kryer me operatorët e shërbimeve utilitare ka rezultuar se:

- i. Furnizuesi i Shërbimit Universal¹³ nuk konfirmon të ketë pasur abonent subjektin e rivlerësimit apo babain e tij.
- ii. Ujësjellës - Kanalizime Mirditë¹⁴ konfirmon furnizimin me ujë, sipas kontratës me nr. *****, të lidhur me babain e subjektit, z. N. P. në Njësinë Administrative R***, e cila, nga të dhënat e regjistruara, rezulton se lidhet me këtë pasuri.

29.7. Në kuadër të hetimit të plotë dhe shterues, në lidhje me këtë pasuri si dhe gjendjen aktuale të saj, pasi është pyetur, subjekti ka shpjeguar se¹⁵: *“Kam banuar në qytetin R***, Mirditë, në *****, apartamenti nr. ***, pallati ***, shkalla ***, kati ***, pasuria nr. *****, ku dhe vazhdoj të banoj aktualisht. Nuk kam banuar në adresë tjetër. Ky apartament ka qenë dhe është në bashkëpronësi të babait N. P., nënës O. P. dhe unë Ilir Përdeda. Në lidhje me këtë*

⁹ Kërkesë për informacion dhe dokumentacion nr. *** prot., datë 7.10.2020 drejtuar ASHK-së; Shkresë nr. *** prot., datë 7.10.2020 drejtuar FSHU-së; Kërkesë për informacion me nr. *** prot., datë 9.3.2021 drejtuar UKT-së Mirditë.

¹⁰ Shkresa dërguar nga ZVRPP-ja Mirditë, në fq. *** të ILDKPKI-së.

¹¹ Neni 20 i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, i ndryshuar. *Për efekt të zbatimit të këtij ligji, të merret për bazë përbërja familjare dhe gjendja e strehimit që rezultojnë në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 1 dhjetor 1992.*

¹² Referohu kartelës së pasurisë së datës 11.10.2016 për apartamentin me sip. 83 m², me nr. pasurie *****, zona kadastrale ***, volum **, faqe ***, pallati ***, shkalla ***, ap ***. *****, paraqitur në ILDKPKI nga subjekti.

¹³ Kërkesë për informacion dhe dokumentacion nr. *** prot., datë 7.10.2020 dhe kthim përgjigjeje me nr. *** prot., datë 16.10.2020.

¹⁴ Kërkesë për informacion me nr. *** prot., datë 9.3.2021 dhe kthim përgjigjeje me nr. *** prot., datë 18.3.2021 UKT-ja Mirditë sh.a., përcjellë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë me nr. *** prot., datë 23.3.2021.

¹⁵ Shih pyetësorin 1.

apartament nuk kam paguar qira. Bashkëpronësia mbi këtë apartament është fituar me kontratën e privatizimit (shitjes) nga ish Ndërmarrja Komunale Banesa Mirditë me nr. *** datë 12.5.1993 hartuar në ish zyrën noteriale Mirditë“.

A.2.1.1. Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie në vitin 1993 (Të ardhurat e deklaruara nga pensioni i babait dhe paga e nënës)

29.8. Për vlerësimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, Komisioni iu referua dokumentacionit të depozituar nga subjekti, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, si dhe dokumentacionit të paraqitur gjatë hetimit administrativ nga subjekti¹⁶, ku ka rezultuar se për periudhën 1988 - maj 1993, babai dhe nëna e subjektit kanë pasur të ardhura me burim nga pensioni dhe nga punësimi prej vitit 1988-1993¹⁷, në vlerën 58,180 lekë.

29.9. Komisioni i ka vlerësuar këto të ardhura të mjaftueshme, për krijimin e pasurisë në vlerën 17,666 lekë, duke konsideruar faktin se pasuria është krijuar me burime nga të ardhurat e prindërve, përpara se subjekti të fillonte detyrën dhe se vlera e privatizimit e përfituar nga zbritja e bërë, si rrjedhojë e pagesës së menjëhershme të çmimit¹⁸, ka qenë e ulët në krahasim me të ardhurat e disponuara nga prindërit e subjektit për periudhën e sipërpërmendur.

30. Si konkluzion për pasurinë apartament me sipërfaqe 83 m², Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin nr. 9049/2003 pasurinë “apartament” me sipërfaqe 83 m², të përfituar nëpërmjet privatizimit nga ish-NKB Mirditë dhe se personat e lidhur me të, babai dhe nëna e tij, kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e saj.

31. Pasuria “bono thesari” në shumën 7,020,000 lekë, me maturim 6 muaj, me datë emetimi 5.1.2017 dhe datë maturimi 6.7.2017, në shoqërinë “Raiffeisen Bank” sh.a., dega R****, në llogarinë rrjedhëse ***** të bashkëshortes së deklaruesit, që ka si burim të ardhurat e akumuluar në vite. Zotërimi 50%. Vlera 7.020.000 lekë.

31.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: i) të ardhurat nga paga e deklaruesit; ii) fitimi i farmacisë së bashkëshortes së deklaruesit në vite; dhe iii) interesa bankarë në vite nga depozita.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite:

31.2. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore (në vijim “DPV”) të administruara nga dosja e ILDKPKI-së, është konstatuar se subjekti ka deklaruar ndër vite gjendje, shtesa dhe pakësime të depozitës, si më poshtë vijon:

- i. në DPV/2006, subjekti ka deklaruar: “Shtuar gjendje në cash në vlerën 700,000 lekë, nga 1,000,000 lekë që ishte, është bërë 1,700,000 lekë dhe është depozituar në llogari të bankare depozite në bankën “Raiffeisen Bank” Agjencia R****, me nr llogarie ***** në emër të bashkëshortes D. L..”, “Vlera 1,700,000 lekë”;
- ii. në DPV/2007 subjekti ka deklaruar: “Shtuar gjendje në cash me vlerën 700,000 lekë, nga 1,700,000 lekë në 2,400,000 lekë, prej të cilave 1,700,000 lekë në depozitë në Raiffeisen Bank Agjencia Mirditë nr ***** llogari në emër të bashkëshortes dhe 700,000 lekë në banesë;
- iii. në DPV/2008, subjekti ka deklaruar: “Shtuar gjendje në depozitë dhe në cash, në vlerën 775,500 lekë, nga 2,400,000 lekë që ishte, është bërë 3,175,550 prej të cilave 2,400,000

16 Në përgjigje të pyetësorit nr.1.

17 Vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016, lëshuar nga DRSSH-ja, fq. **, dosja e ILDKPKI-së, ku referohet pensioni i përfituar nga babai N. P. dhe punësimi i nënës në Uzinën e Bakrit R***.

18 Referuar formularit 2 “treguesit kryesorë për apartamentin” pika 10/ f është shënuar: zbritet 20% e pagesës menjëherë.

- lekë depozitë në llogarinë nr ***** në “Raiffeisen Bank”, 700,000 lekë në cash dhe 75,500 lekë interesa nga depozita. Depozita është në emër të bashkëshortes D. L.”;*
- iv. në DPV/2009, subjekti ka deklaruar: “Shtuar gjendje në depozitë e cash (700,000 lekë), nga 3,175,500 lekë që ishte bëhet 3,875,500 lekë”; **Depozitë bankare në bankën Raiffeisen Bank R****, nr ***** në vlerën 3,000,000 lekë.** Gjendje cash 875,500 lekë;
 - v. në DPV/2010, subjekti ka deklaruar: “Shtuar gjendje në depozitë e cash (700,000 lekë), nga 3,875,500 lekë që ishte bëhet 4,575,500 lekë. **Depozitë bankare në bankën “Raiffeisen Bank” sh.a dega R**** në vlerën 3,000,000 lekë,** gjendje në cash në vlerën 1,575,500 lekë;
 - vi. në DPV/2011, subjekti ka deklaruar: “Shtuar gjendje në depozitë dhe në cash (900,000 lekë), nga 4,575,500 lekë që ishte bëhet 5,475,500 lekë. **Depozitë bankare në bankën “Raiffeisen Bank” sh.a., dega R**** në vlerën 3,000,000 lekë.** Gjendje cash në shumën 2,475,500 lekë;
 - vii. në DPV/2012 subjekti ka deklaruar: “Gjendje lekë në depozitë në bankën “**Raiffeisen Bank” sh.a., dega R****, e krijuar nga depozita e vitit të mëparshëm dhe derdhje nga gjendja cash të krijuara të dyja nga kursimet e pagës dhe xhiro e biznesit të bashkëshortes së deklaruesit në vlerën 4,659,800 lekë”;**
 - viii. në DPV/2014 subjekti ka deklaruar: “**Depozitë në “Raiffeisen Bank” sh.a, shtuar më datë 18.04.2014 në shumën 16,927 lekë shtesë nga interesi bruto i depozitës së deklaruar më parë. Depozitë në “Raiffeisen Bank” sh.a, shtuar më datë 21.10.2014 në shumën 7,960 lekë shtesë nga interesi bruto i depozitës së deklaruar më parë”;**
 - ix. në DPV/2015, subjekti ka deklaruar: “Interes nga depozita në “Raiffeisen Bank”, dega R****, për vitin 2015, në shumën 1,008 lekë. **Depozitë në “Raiffeisen Bank”, dega R****, në shumën 1,000,000 lekë shtuar në depozitën e mëparshme, në datën 30.10.2015, duke u marrë nga gjendja cash”;**
 - x. në DPV/2016, subjekti ka deklaruar: “Gjendja cash e pakësuar në shumën 1,300,000 lekë, nga shuma e mëparshme 2,300,000 lekë dhe mbetur gjendje 1,000,000 lekë. **Pakësuar si rezultat i depozitimit në llogarinë në emër të bashkëshortes në “Raiffeisen Bank” R**** me nr. ***** në shumën 1,101,700 lekë”.**

Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

31.3. Nga hetimi i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se “Raiffeisen Bank”¹⁹ ka konfirmuar çeljen e llogarive me nr. ***** dhe nr. ***** në monedhën lekë në emër të bashkëshortes të subjektit, në të cilën ka pasur investime në depozita me afat dhe në bono thesari, duke filluar nga data 15.3.2007 e në vijim.

31.4. Nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie, konstatohet se bashkëshortja e subjektit ka kryer depozitimin e parë *cash* fillimisht në shumën 1,700,000 lekë, në datën 15. 3.2007, të cilin e ka investuar në depozitë me afat dhe në vijim si rezultat i shumave të shtuara nga vit në vit nga depozitimet e kryera *cash*, me një pjesë nga interesat e përfutur dhe të patërhequr për periudhën 2007-2016, gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 ka qenë 7,020,000 lekë.

31.5. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se përputhej deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” me informacionin e siguruar nga dokumentacioni bankar.

Burimet financiare për krijimin e kësaj pasurie

i. Të ardhurat nga pagat

¹⁹ Shkresa nr. **** prot., datë 3.11.2020.

31.6. Për vlerësimin e këtij burimi, Komisioni iu referua vërtetimeve²⁰ të pagave të lëshuara nga institucionet përkatëse, si dhe lëvizjeve të llogarive²¹ për pagat e tërhequra nga bankat për periudhën 2007-2016, përfituar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, të cilat janë përfshirë në analizën e kryer nga Komisioni.

ii. Fitimi i farmacisë së bashkëshortes së deklaruës në vite

31.7. Në lidhje me verifikimin dhe vlerësimin e të ardhurave nga aktiviteti tregtar i bashkëshortes së subjektit, Komisioni ka administruar dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja, dokumentacionin e paraqitur nga subjekti gjatë hetimit administrativ, si dhe atë të siguruar nga hetimi i kryer, i ka krahasuar dhe analizuar në harmoni me njëra-tjetrën të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni, në përfundim të të cilit, ka rezultuar se:

31.7.1. Me vendimin e Gjykatës²² së Rrethit Gjyqësor Mirditë nr. ***, datë 22.2.2000, bashkëshortja e subjektit D. L., është regjistruar si person fizik për ushtrimin e veprimtarisë private të tregtimit të barnave farmaceutikë. Për ushtrimin e këtij aktiviteti, është pajisur me numrin unik të identifikimit si person i tatueshëm (NUIS) *****, si dhe licencë me të dhëna *****, lëshuar nga QKB-ja²³.

31.7.2. Sipas certifikatës së regjistrimit në organin tatimor²⁴, me nr. serial *****, bashkëshortja e subjektit është pajisur me kodin fiskal nr *****, lëshuar nga dega e Tatim-Taksave të Rrethit Mirditë.

31.8. Lidhur me deklarimin e aktivitetit tregtar të bashkëshortes së subjektit për qëllime tatimore, ka rezultuar e provuar se:

- i. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë²⁵ informon se D. B. L. figuron e regjistruar me NIPT ***** nën administrimin e DRT-së Lezhë;
- ii. Drejtoria Rajonale Tatimore (në vijim “DRT”) Lezhë²⁶ konfirmon se D. L. është e regjistruar si person fizik me NIPT ***** në datën 1.1.2003, si dhe informon se për periudhën 2003-2010 nuk disponon bilance financiare dhe deklarata tatimore lidhur me të ardhurat e deklaruara nga ky tatimpagues, ndërsa për periudhën 2010-2019 janë depozituar deklaratat e tatim fitimit (duke i bashkëlidhur deklaratat); për vitet 2003-2006 ka shlyer detyrimet për taksat vendore (duke bashkëlidhur kopjet e vërtetimeve të shlyerjes për taksat vendore). Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së është konstatuar se DRT-ja Lezhë²⁷ konfirmon qarkullimin dhe fitimin e deklaruar në vitet 2008-2009;
- iii. Bashkia Mirditë²⁸ konfirmon masën e detyrimeve tatimore të paguara për vitin 2007 dhe ka bashkëlidhur librin e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2007;
- iv. në deklaratimet periodike vjetore 2003-2011, të ardhurat nga farmacia janë deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur vetëm në formë qarkullimi të aktivitetit dhe jo si fitim neto të

²⁰ Vërtetim nr. *** prot., datë 24.10.2016 dhe nr. *** prot., datë 19.1.2017, të lëshuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë në dosjen e ILDKPKI-së.

²¹ Kthim përgjigjeje nga institucionet financiare lidhur me kërkesën për informacion, të dërguar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 7.10.2020.

²² Vendim gjykate fq. *** e dosjes së ILDKPKI-së, si dhe konfirmim nga QKB-ja me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.10.2020.

²³ Referuar përgjigjes me nr. *** prot., datë 14.10.2020 të QKB-së, nga e cila është konstatuar se bashkëshortja e subjektit ka qenë e pajisur me licencë tjetër me nr. ***, lëshuar jashtë QKB-së me status “përfunduar afati”.

²⁴ Dosja e ILDKPKI-së fq. ***.

²⁵ Shkresa kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.11.2020.

²⁶ Shkresa kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.10.2020.

²⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 10.11.2016, në dosjen e ILDKPKI-së, fq. ***.

²⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 26.1.2017, në dosjen e ILDKPKI-së, fq. ***.

personit të lidhur, ndërsa në DPV 2012-2016 është deklaruar fitimi neto nga ushtrimi i aktivitetit.

Analizë për fitimin neto nga xhiroja e aktivitetit tregtar për periudhën 2000-2016

31.9. Komisioni ka administruar dhe vlerësuar në cilësinë e provave dokumentacionin lartreferuar, nga ku ka rezultuar se, për periudhën nga regjistrimi si person fizik (v. 2000) e deri në vitin 2006, nuk është deklaruar fitimi neto i realizuar, por disponohet informacion vetëm për qarkullimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale mbi këtë qarkullim.

32. Për vlerësimin e fitimit neto që mund të ketë realizuar bashkëshortja e subjektit për këtë periudhë, Komisioni mori si referencë fitimin neto të deklaruar nga personi fizik pranë organeve tatimore në vitet 2007-2016 dhe e analizoi atë.

32.1. Në një vlerësim aritmetik/proporcional të fitimit neto të deklaruar nga personi fizik pranë organeve kompetente në vitet 2007-2016, fitimi neto rezulton të ketë qenë në masën 14%, si raport midis fitimit të realizuar kundrejt qarkullimit të deklaruar.

32.3. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit të parë, ka deklaruar se fitimi neto i realizuar nga aktiviteti i farmacisë për periudhën 2000-2006 ka qenë sa 12% e qarkullimit të realizuar për çdo vit, duke paraqitur edhe shifrat përkatësisht për çdo vit. Vlera mesatare e fitimit neto mujor nga farmacia e bashkëshortes, për periudhën 2003-2006, është deklaruar nga subjekti rreth 46,000 lekë/muaj. Ndërsa për vitet e tjera 2007-2016 ka referuar të njëjtin fitim neto që rezulton edhe nga dokumentacioni i sipërcituar i deklaruar pranë organeve kompetente, i cili është mesatarisht 78,000 lekë / muaj.

32.4 Pas analizimit të dokumentacionit më lart, si dhe krahasimit të tij me shpjegimet dhe deklaratimet e subjektit, Komisioni përgatiti tabelën me fitimin neto nga aktiviteti tregtar i bashkëshortes së subjektit sikurse më poshtë, fitim i cili është konsideruar nga Komisioni në kuptim të analizës financiare.

Tabela nr. 1. Në lidhje me fitimin neto të realizuar kundrejt qarkullimit nga aktiviteti farmaci “D***”.

Viti	Qarkullimi sipas Tatimeve / Bashkisë	Taksë vendore / Tat fitimi	Fitimi sipas dok tatimor	Fitimi i deklaruar nga subjekti	% Fitim dok tatimor / Qarkullim	Fitim deklaruar / Qarkullim
2000	500 000	20 000	Nuk ka informacion	60 000		12%
2001	1 200 000	33 332	Nuk ka informacion	144 000		12%
2002	1 300 000	40 000	Nuk ka informacion	156 000		12%
2003	3 103 112	124 124	Nuk ka informacion	380 000		12%
2004	5 454 014	155 155	Nuk ka informacion	660 000		12%
2005	5 312 910	150 726	Nuk ka informacion	650 000		12%
2006	4 463 270	80 000	Nuk ka informacion	530 000		12%
2007	5 710 098	89 500	667 482		12%	
2008	2 240 500	89 391	804 517		36%	
2009	6 700 000	96 887	871 174		13%	

2010	6 662 082	91 498	823 483		12%	
2011	7 053 940	106 932	960 768		14%	
2012	7 355 122	101 956	917 603		12%	
2013	6 285 011	73 304	659 735		10%	
2014	9 081 093	162 852	922 826		10%	
2015	9 877 234	210 760	194 307	1	12%	
2016	11 860 286	264 378	498 141	1	13%	

iii. *Interesa banke në vite nga depozita*

32.5. Në lidhje me këtë burim, Komisionit i ka rezultuar nga hetimi²⁹ se në llogarinë në të cilën janë investuar fondet në depozitë me afat ose në bono thesari, në mënyrë periodike janë kredituar interesat në vlerën rreth 964,000 lekë për periudhën 2007-2016, nga të cilat një pjesë, rreth 338,500 lekë, janë tërhequr nga subjekti dhe personi i lidhur, duke shërbyer si të ardhura për vitin 2010-2011, ndërsa pjesa tjetër, rreth 625,500 lekë, në vitet 2008-2009 dhe 2012-2016 është bashkuar me principalin e depozitës, duke shërbyer si burim krijimi për shtesën e depozitës me afat/bonove të thesarit ndër vite.

32.6. Si konkluzion për pasurinë bono thesari, subjekti ka kryer deklaram të mjaftueshëm, duke deklaruar rregullisht ndër vite ndryshimet e kryera në pasurinë e llojit “depozitë”, si rezultat i investimit në të, deklarime këto të cilat përputhen me investimet e kryera nga bashkëshortja e subjektit në depozitë pranë “Raiffeisen Bank”. Subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi të krijojnë pasurinë e llojit “depozitë” në vlerën totale 7,020,000 lekë me të ardhura të ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

33. Pasuria e llojit “gjendje likuiditetesh cash”, në shumën 1,000,000 lekë

33.1. Lidhur me burimin e krijimit

33.1.1. Në deklaratën “Vetting” subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të gjendjes *cash*.

33.1.2. Nga verifikimi i deklarimeve ndër vite ka rezultuar se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar në disa deklarata periodike vjetore (në deklaratën para fillimit të detyrës dhe më pas nga DPV/2012 e vijim), se këto fonde në formë *cash* janë krijuar nga të ardhurat nga paga dhe nga aktiviteti tregtar i farmacisë, të cilat janë përdorur edhe për krijimin e pasurisë depozitë/shtesa në depozitën bankare në vitet pasardhëse.

Deklarimi në vite i likuiditeteve në formë kursimesh gjendje cash

33.2. Nga verifikimi i DPV- ve ndër vite, konstatohet se subjekti ka deklaruar në mënyrë periodike kursime *cash*, duke filluar nga deklarata e parë (v. 2003) e deri në DPV/2016, si vijon:

- i. në deklaratën para fillimit të detyrës viti 2003 deklararon për herë të parë gjendje *cash* në vlerën 500,000 lekë me burim krijimi nga pagat;
- ii. në DPV/2005 ka deklaruar: shtesë 500,000 lekë pa deklaruar burimin e krijimit;

²⁹ Kthim përgjigjeje nr. ***, datë 3.11.2020 nga “Raiffeisen Bank”.

- iii. në DPV/2006 ka deklaruar: shtesë 700,000 lekë pa deklaruar burimin e krijimit;
- iv. në DPV/2007 ka deklaruar: shtesë 700,000 lekë pa deklaruar burimin e krijimit dhe pakësim 1,700,000 lekë kaluar në bankë;
- v. në DPV/2008 ka deklaruar: shtuar 75,500 lekë nga interesat;
- vi. në DPV/2009 ka deklaruar: shtuar gjendje 100,000 lekë pa deklaruar burimin e krijimit;
- vii. në DPV/2010 ka deklaruar: shtuar gjendje 700,000 lekë pa deklaruar burimin e krijimit;
- viii. në DPV/2011 ka deklaruar: shtuar gjendje *cash* 900,000 lekë pa deklaruar burimin e krijimit;
- ix. në DPV/2012 ka deklaruar: gjendje *cash* 1,500,000 lekë e krijuar nga kursimet e pagës dhe xhiro e biznesit të bashkëshortes së deklaruesit;
- x. në DPV/2013 ka deklaruar: gjendje *cash* 1,800,000 lekë e krijuar nga të ardhurat e përfituara gjatë vitit 2013 të pagës së tij, të bashkëshortes dhe xhros së fitimit të biznesit të bashkëshortes; në DPV/2014 ka deklaruar: gjendje *cash* në shumën 1,000,000 lekë, shtuar nga ajo e deklaruar më parë, e krijuar si diferencë nga të ardhurat për vitin 2014 nga paga e tij si gjyqtar, paga e bashkëshortes si farmacistë private dhe fitimi neto i farmacisë për vitin 2014;
- xi. në DPV/2015 ka deklaruar: shtuar gjendja *cash* me 500,000 lekë, të ardhura të krijuara nga paga dhe fitimi i farmacisë së bashkëshortes dhe shtuar depozitën 1,000,000 lekë, duke marrë nga gjendja *cash*;
- xii. në DPV/2016 ka deklaruar: gjendje *cash* e pakësuar në shumën 1,300,000 lekë dhe mbetur gjendje 1,000,000 lekë. Pakësuar si rezultat i depozitimit në llogari në emër të bashkëshortes në “Raiffeisen Bank”.

33.3. Për të vlerësuar përputhshmërinë e deklarimeve vjetore të subjektit me atë të deklaratës së rivlerësimit kalimtar, Komisioni iu referua deklarimeve të subjektit, duke nisur nga deklarata e parë para fillimit të detyrës deri në deklaratën e vitit 2016 e duke e pasqyruar gjendjen *cash* me shtesat/pakësimet për çdo vit, në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 2.

Viti	Shuma në lekë	Deklarimi në DPV-të 2003-2016 në lidhje me gjendjen <i>cash</i>
31.12.2003	500,000	Gjendje <i>cash</i> 500,000 lekë në banesë (nga paga)
2004	-	Nuk ka deklarim për shtesa ose pakësime <i>cash</i> .
31.12.2004	500,000	
2005	500,000	Gjendje <i>cash</i> në banesë shtuar 500,000 lekë dhe është 1,000,000 lekë.
31.12.2005	1,000,000	
2006	700,000	Shtesë gjendje në <i>cash</i> (700,000 lekë) nga një milion që ishte, është bërë 1,700,000 lekë (Depozituar në llogarinë nr. ***** në emër të D.L.). 15.3.2007
31.12.2006	1,700,000	
2007	700,000	Shtuar gjendje në <i>cash</i> me vlerën 700,000 lekë, nga 1,700,000 lekë në 2,400,000 lekë 700,000 lekë në banesë.
2007	(1,700,000)	1,700,000 lekë në depozitë në “Raiffeisen Bank” Agjencia Mirditë nr ***** llogari ne emër të bashkëshortes. 15.3.2017.
31.12.2007	700,000	
2008	75,500	Shtuar gjendje në depozitë dhe <i>cash</i> nga 2,400,000 lekë që ishte është bërë 3,175,500 lekë prej të cilave 2,400,000 lekë depozitë në llogarinë

		***** në "Raiffeisen Bank" / 700,000 lekë Cash dhe 75,550 lekë interesa nga depozita në emër të bashkëshortes D. L..
31.12.2008	775,500	
2009	100,000	Shtuar gjendje në depozitë e <i>cash</i> nga 3,175,500 lekë që ishte, shkon në 3,875,500 lekë / BSH Depozitë bankare 3,000,000 lekë, gjendje në cash 875,500 lekë
31.12.2009	875,500	
2010	700,000	Shtuar gjendja (700,000 lekë) në depozitë dhe në <i>cash</i> nga 3,875,500 lekë që ishte, bëhet 4,575,500 lekë. /BSH Depozitë bankare në "Raiffeisen Bank" sh.a., dega R****, shuma 3,000,000 lekë. Gjendje cash 1,575,500.
31.12.2010	1,575,500	
2011	900,000	Shtuar gjendja (900,000 lekë) në depozitë dhe në <i>cash</i> nga 4,575,000 lekë që ishte, bëhet 5,475,500 lekë. / BSH Depozitë bankare në bankën "Raiffeisen", dega R**** 3,000,000 lekë. Gjendje në cash 2,475,500 lekë.
31.12.2011	2,475,500	
2012	(975,500)	Gjendje cash (1,500,000 lekë) e krijuar nga kursimet e pagës dhe xhiro e biznesit të bashkëshortes së deklaruesit. Gjendje lekë në vlerën 4,659,800 lekë, depozitë në bankën "Raiffeisen Bank" sh.a., dega R****, e krijuar nga depozita e vitit të mëparshëm dhe derdhje nga gjendja <i>cash</i> .
31.12.2012	1,500,000	
2013	300,000	Gjendje cash (1,800,000 lekë) e krijuar nga të ardhurat e përfituara gjatë vitit 2013 të pagës së subjektit, të bashkëshortes dhe xhiros së fitimit të biznesit të bashkëshortes.
31.12.2013	1,800,000	
2014	1,000,000	Gjendja cash në shumën 1,000,000 lekë, shtuar nga ajo e deklaruar më parë, e krijuar si diferencë nga të ardhurat për vitin 2014 nga paga e subjektit si gjyqtar paga e bashkëshortes si farmacistë private dhe dhe fitimi neto i farmacisë për vitin 2014.
31.12.2014	2,800,000	
2015	500,000	Shtuar gjendja cash me 500,000 lekë, të ardhura të krijuara nga paga dhe fitimi i farmacisë së bashkëshortes.
2015	1,000,000	Depozitë në "Raiffeisen Bank", dega R****, në shumën 1,000,000 lekë, shtuar në depozitën e mëparshme në datën 30.10.2015, duke marrë nga gjendja cash.
31.12.2015	2,300,000	
2016	1,300,000	Gjendja cash e pakësuar në shumën 1,300,000 lekë dhe mbetur gjendje 1,000,000 lekë. Pakësuar si rezultat i depozitimit në llogari në emër të bashkëshortes në "Raiffeisen Bank" R**** me nr. *****.
31.12.2016	1,000,000	
Gjendja e deklaruar në deklaratën "Vetting", më 28.1.2017	1,000,000	

33.4. Si konkluzion për pasurinë e luajtshme gjendje cash, Komisioni vlerëson se përputhen deklaratimet e subjektit ndër vite për vlerën e përgjithshme të kursimeve *cash* me gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën "Vetting". Komisioni gjithashtu vëren se, edhe pse subjekti ka kryer deklaram të pasaktë për këtë pasuri, duke mos deklaruar në disa vite dhe në deklaratën "Vetting" burimet e krijimit të gjendjes *cash*, kjo pasaktësi nuk sjell pasoja në drejtim të identifikimit të burimit të ligjshëm për krijimin e gjendjes *cash* ndër vite, duke marrë në konsideratë se: i) subjekti ka deklaruar burimin e krijimit të gjendjes *cash* për herë të parë në deklaratën përpara fillimit të detyrës; ii) subjekti ka deklaruar në disa deklaratat periodike vjetore se me pagën e tij dhe të bashkëshortes, si dhe fitimin nga aktiviteti tregtar i bashkëshortes kanë krijuar gjendjen *cash* (ndryshimin e saj) dhe depozitën bankare; iii) subjekti i ka deklaruar në deklaratat periodike dhe në deklaratën "Vetting" të ardhurat e disponuara me

burim nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe të ardhura nga aktiviteti tregtar; iv) nga hetimi i Komisionit nuk rezultuan të ardhura të tjera të përfituara nga subjekti apo bashkëshortja e tij. Për rrjedhojë, mosdeklarimi i burimit të krijimit nga subjekti në deklaratën “Vetting” dhe në disa deklarata periodike, nuk përbën deklaram të pamjaftueshëm për kriterin pasuror, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

33.4.1. Në lidhje me mjaftueshmërinë për të krijuar gjendjen *cash* me burime të ligjshme, nga analizimi i burimeve, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare për krijimin e shumën 1,000,000 lekë me burime të ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

34. Gjendje në lekë në llogarinë me numër *** , në shumën 21,655 lekë, në “Alpha Bank”**

34.1. Si burim krijimi të kësaj llogarie, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga si gjqqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

34.2. Nga hetimi i Komisionit³⁰ është konfirmuar llogaria bankare e pagës në emër të subjektit të rivlerësimit.

PASURITË E DEKLARUARA NGA BASHKËSHORTJA E SUBJEKTIT/PERSON I LIDHUR

35. Në deklaratën “Vetting”, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar pasuritë dhe të drejtat reale, si më poshtë:

35.1. Gjendje lekë në llogarinë rrjedhëse³¹ me nr. *** , në BKT, dega R****, në emër të subjektit “D. L.”,** person fizik me numër NIPT ***** , që ka si burim të ardhurat e siguruara nga ushtrimi i aktivitetit privat “Farmaci” prej bashkëshortes gjatë vitit 2016 në shumën 1,200,175 lekë, në masën 100%.

35.2. Si burim krijimi të kësaj llogarie, personi i lidhur me subjektin ka deklaruar të ardhurat e siguruara nga ushtrimi i aktivitetit privat “Farmaci” gjatë vitit 2016.

35.2.1. Nga hetimi i Komisionit³² është konfirmuar llogaria bankare e biznesit e hapur nga D. L. me NIPT ***** .

36. Gjendje lekë në llogarinë individuale me nr. *** në BKT, dega R****, në emër të D. L. në shumën 2,752 lekë në masën 100%.**

36.1. Si burim krijimi të kësaj llogarie, personi i lidhur me subjektin ka deklaruar të ardhurat nga paga që është paguar nga subjekti “D. L.” gjatë vitit 2016.

36.2. Nga hetimi i Komisionit³³ është konfirmuar llogaria rrjedhëse e hapur nga bashkëshortja e subjektit.

37. Bono thesari me maturim 6 muaj, me datë emetimi 5.1.2017 dhe datë maturimi 6.7.2017, në bankën “Raiffeisen Bank”, dega R****, në llogarinë rrjedhëse ***** të bashkëshortes së deklaruesit, që ka si burim të ardhurat e akumuluar në vite. Zotërimi 50%. Vlera 7,020,000 lekë.

³⁰ Shkresë nr. ***, datë 7.10.2020 dhe kthim përgjigjeje “Alpha Bank” me nr. *** prot., datë 21.10.2020.

³¹ Komisioni gjatë hetimit ka identifikuar llogarinë e personit fizik për shkak të deklaramit nga bashkëshortja e subjektit, edhe pse kjo e fundit nuk ka pasur detyrim ta deklarojë.

³² Shkresë nr. *** prot., datë 7.10.2020 dhe kthim përgjigjeje nga BKT-ja me nr. *** prot., datë 26.10.2020.

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 7.10.2020 dhe kthim përgjigjeje nga BKT-ja me nr. *** prot., datë 26.10.2020.

37.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: i) të ardhura nga paga e deklaruesit; ii) fitimi i farmacistë së bashkëshortes së deklaruesit në vite; dhe iii) interesa banke në vite nga depozita.

37.2. Kjo pasuri është trajtuar më lart tek pasuritë e subjektit të rivlerësimit, për të cilën Komisionit i ka rezultuar se përputhen deklarimet me informacionin bankar dhe se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi të krijojnë pasurinë depozitë në vlerën totale 7,020,000 lekë, me të ardhura të ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, sipas nenit D pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

38. Gjendje në llogarinë rrjedhëse në lekë pranë “Raiffeisen Bank” dega Mirditë, llogari individuale me numër *****, në shumën 76,274 lekë, në masën 100%.

38.1 Si burim krijimi të kësaj llogarie personi i lidhur me subjektin ka deklaruar tepriçë llogarie nga arkëtimet, interesat e depozitës.

38.2. Nga hetimi i Komisionit³⁴ është konfirmuar llogaria individuale e hapur nga bashkëshortja e subjektit.

39. Njësi shërbimi me destinacion “farmaci”, e marrë me qira nga D. L. në datën 21.3.2000 e në vazhdim nga qiradhënësi L. M., në R***, *****, rruga “****”, kati i parë, me nr. pasurie ****, zona kadastrale ****, volum **, faqe **, prej së cilës është marrë me qira vetëm sipërfaqe prej 37.8 m² dhe përdoret si farmaci, sipas kontratave të qirasë datë 21.03.2000 (nr. **** rep., dhe nr. **** kol., datë 27.3.2000 e notere V. B.), e ndryshuar me kontratën e datës 26.03.2000 dhe të datës 21.04.2000, me nr. **** rep., nr. **** kol., kontrata e qirasë nr. **** rep., nr. **** kol., datë 1.4.2005, kontrata e qirasë nr. **** rep., nr. **** kol., datë 28.5.2010, si dhe kontrata e qirasë datë 28.12.2013, e vërtetuar nga noteri, duke deklaruar vlerën e kontratës për secilën kontratë. Pjesa takuese 100%.

39.1. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar kontratat e qirasë të lidhura nga bashkëshortja e subjektit dhe qiradhënësi L. M., si dhe dokumentacionin bashkëlidhur lidhur me pronësinë e qiradhënësit, nga ku është konstatuar se kontrata e parë e qirasë është lidhur në datën 21.3.2000 midis bashkëshortes së subjektit dhe qiradhënësit, e cila është ndryshuar ndër vite deri në vitin 2005, në lidhje me kushtin e çmimit dhe modalitetet e pagesës, elemente këto, të cilët janë konsideruar nga Komisioni për efekt të analizës financiare. Në vijim, nga viti 2005 e deri në 2020 janë lidhur disa kontrata qiraje me palë qiramarrëse farmaci “D****” dhe qiradhënësi L. M.

39.2. Në përfundim të hetimit, Komisioni ka përlllogaritur qiranë si shpenzim të kryer nga personi i lidhur, bazuar në deklaratat periodike vjetore dhe deklaratën “Vetting”.

40. Në seksionin e të dhënave konfidenciale, bashkëshortja e subjektit, ka deklaruar gjithashtu bonot e thesarit në shumën 7,020,000 lekë dhe gjendje *cash* në shumën 1.000.000 lekë, pasuri të cilat janë trajtuar më lart.

Çështje të tjera nga hetimi administrativ

41. Komisioni e ka shtrirë hetimin administrativ³⁵ përtej deklarimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të, në kuptim të hetimit të gjithanshëm, me qëllim identifikimin e ndonjë pasurie apo të drejtë reale të padeklaruar nga subjekti apo personat e lidhur.

41.1. Nga ky hetim, është konstatuar se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRR”) ka informuar në lidhje me blerjen e një autoveture, tip “Mercedes – Benz”, nga vajza e subjektit I. P.

³⁴ Shkresë nr. **** prot., datë 7.10.2020 dhe kthim përgjigjeje nga “Raiffeisen Bank” me nr. **** prot., datë 3.11.2020.

³⁵ Shih dosjen e hetimit administrativ.

41.2. Nga administrimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DPSHTRR-ja, ka rezultuar se në datën 14.12.2019, shtetasi E. Ll., në cilësinë e personit fizik, i ka shitur vajzës së subjektit I. P. një autoveturë, tip “Mercedes- Benz B200 CDI”. Për këtë shitblerje është lëshuar fatura tatimore me nr. ***, datë 14.12.2019, sipas së cilës është shënuar vlera 240.000 lekë.

41.3. Në vijim, Komisioni kërkoi³⁶ nga ILDKPKI-ja vënien në dispozicion të DPV/2019, për të kryer verifikime lidhur me deklarinimin e kësaj pasurie.

41.4. Nga administrimi i DPV/2019, përcjellë nga ILDKPKI³⁷ rezulton se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar tek seksioni i ndryshimit të pasurive “*pakësuar shuma 240,000 lekë për pagesën me datën 16.12.2019 në llogari të E. Ll. e çmimit të blerjes së mjetit “Mercedez Benz” me targë ***** nga vajza I. P.*” Gjithashtu, në seksionin e të dhënave konfidenciale, ajo ka deklaruar se pagesa është kryer nëpërmjet transfertës së datës 16.12.2019, nga llogaria personale e saj në Bankën Kombëtare Tregtare me nr. llogarie *****.

41.5. Komisioni verifikoi mënyrën e kryerjes së transaksionit, sipas së cilës konfirmohet³⁸ pagesa e çmimit të blerjes së automjetit nëpërmjet transfertës bankare nga llogaria personale e bashkëshortes së subjektit pranë BKT-së drejt shitësit.

41.6. Nga verifikimi i burimit të transfertës bankare rezultoi se këto fonde kanë ardhur nga maturimi i depozitës pranë bankës “Raiffeisen Bank”, depozitë e cila është krijuar nga maturimi i bonove të thesarit, të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur me të, pasuri e cila është trajtuar në këtë vendim.

42. Nga verifikimi i deklaratës periodike vjetore të vitit 2019 rezulton se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se i ka dhënë hua vëllait të saj V. L. në shumën 400.000 lekë.

42.1. Komisioni verifikoi mënyrën e kryerjes së transaksionit³⁹, sipas së cilës, ka rezultuar se huaja është kaluar nëpërmjet transfertës bankare nga llogaria personale e bashkëshortes së subjektit pranë BKT-së drejt vëllait të saj V. L..

42.2. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare rezultoi se shuma e dhënë hua ka pasur burim pagat dhe fitimin për shkak të ushtrimit të aktivitetit tregtar të bashkëshortes së subjektit.

43. Pas përfundimit të hetimit, Komisioni nuk gjeti *indicie* për vijimin e hetimeve të tjera në kuptim të kriterit të vlerësimit pasuror, sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

44. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarinimin të mjaftueshëm për kriterin pasuror.

44.1. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive bono thesari dhe gjendje *cash*.

44.2. Nga hetimi administrativ i kryer nuk rezultuan pasuri të fshehura apo të drejta reale të padeklaruara nga subjekti dhe personat e lidhur me të, si dhe nuk rezultuan pasuri në pronësi ose në përdorim të subjektit apo personave të lidhur me të, më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht.

44.3. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Përdeda, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të gurmës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

³⁶ Kërkesë drejtuar ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë 9.3.2021.

³⁷ Kthim përgjigjeje me nr. *** prot., datë 16.3.2021.

³⁸ Shkresë BKT-ja me nr. *** prot., datë 26.10.2020.

³⁹ Shkresë BKT-ja me nr. *** prot., datë 26.10.2020.

B. KONTROLLI I FIGURËS

45. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Ilir Përdeda, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse ai ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

45.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 31.10.2017 mbi kontrollin e figurës, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 18.3.2021, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar se: i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

45.2. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit z. Ilir Përdeda.

Hetimi i Komisionit

45.3. Nga verifikimi i deklaratës për kriterin e figurës (shtojca nr. 3), të dorëzuar në DSIK nga subjekti i rivlerësimit, u konstatua se subjekti ka deklaruar në pjesën 5 titulluar “Të dhëna për sigurinë”, në gjuhën “b” se *“djali i xhaxhait i quajtur A. F. P., ka qëndruar në Itali një muaj i arrestuar për hashash në moshë të mitur.”*

45.4. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të DSIK-së, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

45.5. Komisioni, gjatë hetimit të kryer, përfshirë këtu edhe informacionin e marrë nga publiku sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, nuk identifikoi *indicie* apo rrethana në drejtim të ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 38 pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

45.6. Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të gjuhës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Karriera profesionale

46. Subjekti i rivlerësimit Ilir Përdeda ka marrë titullin “Jurist” në Universitetin e Tiranës në datën 27.6.1993. Pas studimeve në datën 20.10.1993 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mirditë dhe me vendimin nr. *** të Këshillit është emëruar kryetar i kësaj gjykate, detyrë të cilën e ka mbajtur deri me emërimin gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendim të KLD-së nr. 235, datë 24.10.2008. Në vijim z. Përdeda me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 332, datë 20.5.2013 është deleguar në detyrën e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë deri në datën 18.11.2016. Aktualisht ushtron detyrën e gjyqtarit të kësaj gjykate.

Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor⁴⁰

47. Raporti për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

47.1. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: 1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga të dhënat dhe dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; 2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe 3) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

47.2. Raporti ka analizuar të dhënat nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016, në përfundim të të cilit, ka rezultuar se subjekti:

a) për aftësinë profesionale: ka aftësi në arsyetimin ligjor dhe respekton standardin për një proces të rregullt;

b) për aftësitë organizative: ka përballuar ngarkesë mbi standardin minimal⁴¹ dhe i kushton rëndësi arsyetimit në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore, duke respektuar afatet ligjore;

c) për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale: nuk ka të dhëna negative për etikën dhe nuk ka pasur raste të konfliktit të interesit;

ç) për aftësitë personale dhe angazhimin profesional: shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve dhe i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së

48. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Ilir Përdeda janë paraqitur në Inspektoratin e KLD-së 17 ankesa gjithsej (2 në vitin 2013, 7 në vitin 2014, 2 në vitin 2015, 6 në vitin 2016).

48.1. Nga këto, 9 ankesa (2 në vitin 2013, 3 në vitin 2014, 3 në vitin 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar. Ndërsa në lidhje me 8 ankesat e tjera, ka rezultuar si më poshtë: 3 ankesa të vitit 2014, nga këto 2 verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mosrespektim formal të ligjit ndër të cilat për 1 është vendosur evidentimi për efekt vlerësimi etik e profesional, për 1 tjetër nuk kanë rezultuar shkelje nga gjyqtari, ndërsa ankesa tjetër e vitit 2014, paraqitur si informacion periodik nga kryetari i gjykatës për mosdorëzim në afat të vendimeve gjyqësore për të cilën nuk ka rezultuar shkelje nga gjyqtari; 2 ankesa të vitit 2015 ndër të cilat 1 verifikuar për zvarritje gjykimi, nuk ka rezultuar shkelje nga gjyqtari dhe 1 për mosrespektim formal të ligjit; 3 ankesa të vitit 2016, nga të cilat, 1 verifikuar për mosrespektim formal i ligjit, ku nuk ka rezultuar shkelje nga gjyqtari, 2 ankesa të vitit 2016, të cilat janë informacion periodik nga kryetari i gjykatës janë verifikuar për mosdorëzim në afat të vendimeve gjyqësore dhe shkeljet janë regjistruar për efekt vlerësimi etik e profesional.

48.2. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Ilir Përdeda përgjatë periudhës së rivlerësimit, nga ministri i Drejtësisë nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë

⁴⁰ Raport me nr. *** prot., datë 20.10.2020 për periudhën 8.10.2013 - 8.10.2016, protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 27.10.2020.

⁴¹ Referuar pikës 3, shkronja “g”, të aneksit 1 të sistemit të vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe çështjesh civile me palë kundërshtare, pra, për 3 vjet jo më pak se 600 çështje.

kërkesë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë (KLD) ndonjë masë për procedim disiplinor.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

49. Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të ish - KLD-së, mbi të cilat është hartuar raporti, ku në përfundim identifikoi nga burimet arkivore të regjistruara për efekt të vlerësimit etik e profesional 3 ankesa ndaj subjektit, për të cilat iu kërkuan shpjegime:

- ankesa e vitit 2014, me nr. *** prot., datë 15.5.2014, paraqitur nga ankuesi F. S., me objekt “Zvarritje gjykimi”.
- 2 (dy) ankesa të vitit 2016: nr. *** prot., datë 29.6.2016 dhe me nr. *** prot., datë 2.6.2016, paraqitur nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me objekt “Mosdorëzim në afat të vendimeve të arsyetuara”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

49.1. Në lidhje me ankesën e shtetasit F. S. për zvarritjen e gjykimit të çështjes penale nr. *****, me të pandehur shtetasin S. S., subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se *kjo çështje ka pasur dinamikë që lidhej me shqyrtimin e çështjes në fillim nga një gjyqtar tjetër, i cili ka zhvilluar dy seanca; me ndryshimin e prokurorit të seancës tri herë dhe, për rrjedhojë, seancat janë shtyrë 4 herë; mungesa e prokurorit në 9 seanca dhe avokatit të zgjedhur në 4 seanca; parashtrimi i kërkesës për transferim të çështjes ku është pritur vendimi i Gjykatës së Lartë; njoftimi i të pandehurit në gjendje të lirë dhe shtyrje e seancave; paraqitja e padisë civile gjatë gjykimit penal nga pala e dëmtuar; mungesa e dëshmitarëve ndonëse është urdhëruar shoqërimi i detyrueshëm. Të gjitha rrethanat e mësipërme kanë shkaktuar kompleksitet procedural në gjykimin e çështjes e për rrjedhojë dhe zvarritje të saj.*

49.1.1. Në lidhje me mosdorëzimin në afat të disa prej vendimeve të arsyetuara gjatë vitit 2016, subjekti ka shpjeguar se *sipas raportit të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, gjatë vitit 2016 ka zhvilluar në total 2843 seanca, mesatarisht 11 seanca në ditë, fakt që provon për një ngarkesë dukshëm më të lartë se ajo normale, e cila është reflektuar në mosarsyetimin dhe dorëzimin në kohë të vendimeve gjyqësore; arsye tjetër që ka të bëjë me neglizhencën e tij në përmbushjen e detyrës nuk ka patur në rastin konkret.*

49.2. Subjekti paraqiti në cilësinë e provës raportin e datës 13.4.2021 për përdorimin e sistemit të regjistrimit audio për periudhën 1/1/2016 - 31/12/2016, i nxjerrë nga sistemi elektronik ICMIS.

Vlerësimi i Komisionit

49.3. Pas administrimit të shpjegimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se në lidhje me ankesën e parë me objekt zvarritje të gjykimit, subjekti ka arritur të shpjegojë dhe të justifikojë vonesat e shkaktuara gjatë shqyrtimit të çështjes penale nr. *****, me të pandehur shtetasin S. S., për sa çështja ka pasur dinamikë procedurale, si dhe rrethana mosparaqitjeje të organit të akuzës dhe të avokatit mbrojtës, shkaqe këto të cilat i kanë diktuar subjektit shtyrje të seancave gjyqësore.

49.4. Në lidhje me mosdorëzimin në afat të disa prej vendimeve të arsyetuara, Komisioni vlerëson se referuar raportit vjetor për seancat e zhvilluara me audio të datës 13.4.2021, subjekti i rivlerësimit ka pasur një ngarkesë shumë të lartë të çështjeve për shqyrtim për vitin 2016, duke e tejkaluar standardin sasior të kërkuar në germën “g” të pikës 3, të aneksit 1 të sistemit

të vlerësimit të gjyqtarëve dhe se kjo ngarkesë duket të jetë bërë shkak për vonesën në arsyetimin e vendimeve nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni arrin në këtë konkluzion, nisur edhe nga fakti që nuk pasur një dispozitë konkrete imperative në drejtim të normimit të afatit për arsyetimin e vendimeve, afat i cili u përfshi në legjislacionin procedural penal dhe civil me ndryshimet e vitit 2017.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

50. Komisioni ka administruar 20 denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit, nga këto 19 denoncime nga publiku (18⁴² denoncime të shqyrtuara gjatë procesit administrativ, 1⁴³ denoncim është shqyrtuar pas mbylljes së hetimit) si dhe 1⁴⁴ denoncim nga faktet mediatike i administruar kryesisht nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

50.1. Në lidhje me këto denoncime, Komisioni pasi i administroi dhe kreu hetim për disa nga denoncimet që përmbanin *indicie*, i kaloi të drejtën subjektit për të paraqitur shpjegime në lidhje me 6 denoncime⁴⁵ si dhe i kaloi barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit në lidhje me 1 denoncim⁴⁶.

50.2. Subjekti paraqiti shpjegimet e tij si dhe provat, të cilat pasi u administruan dhe u vlerësuan veç e veç nga Komisioni, u gjetën bindëse në lidhje me 5 denoncime⁴⁷, për sa nuk u identifikuan elemente cenuese të etikës dhe kriterit profesional të subjektit.

50.3. Në lidhje me dy denoncime (denoncim i shtetasit Gj. Ç. regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 18.12.2017, si dhe rasti mediatik i lirimit nga burgu i ish-kryetarit të Komunës *****, Mirditë, z. P. B.), Komisioni gjeti disa problematika:

⁴² 1. Denoncim i shtetasit Z. Gj., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 7.6.2018; 2. Denoncim i shtetasit P. G., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 20.5.2019; 3. Denoncim i shtetasit Gj. Ç., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 18.12.2017; 4. Denoncim i shtetasit P. P., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 8.2.2018; 5. Denoncim i shtetasit K. M., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 8.2.2018; 6. Denoncim i shtetasit Z. Gj., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 18.1.2018; 7. Denoncim i shtetasit N. Ç., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 26.2.2018; 8. Denoncim i shtetasit A. M., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 21.12.2020; 9. Denoncim i shtetasit E. C., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 22.1.2019; 10. Denoncim i shtetasit D. V., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 17.12.2018; 11. Denoncim i shtetasit K. D., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 31.10.2018; 12. Denoncim e shtetasit P. S., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot. datë 17.10.2018; 13. Denoncim i shtetasit Gj. N. (në cilësinë e avokatit mbrojtës), regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 24.07.2018; 14. Denoncim i shtetasit M. N., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 3.9.2018; 15. Denoncim i shtetasit P. P., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 13.7.2018; 16. Denoncim i Bankës Kombëtare Tregtare, regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 23.2.2021; 17. Denoncim i shtetasit Gj. C., përcjellë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 12.12.2017; 18. Denoncim i shtetasit Xh. J., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 5.12.2017;

⁴³ 19. Denoncim i datës 19.4.2021 i paraqitur nga shtetasi N. Gj.;

⁴⁴ Rasti i lirimit nga burgu i ish-kryetarit të Komunës *****, Mirditë, z. P. B. (P. D.).

⁴⁵ 1. Denoncim i shtetasit N. Ç. regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 26.2.2018; 2. Denoncim i shtetasit A. M., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 21.12.2020; 3. Denoncim i shtetasit Gj. N. (në cilësinë e avokatit mbrojtës), regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 24.7.2018; 4. Denoncim i Bankës Kombëtare Tregtare, regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 23.2.2021; 5. Rasti i lirimit nga burgu i ish-kryetarit të Komunës *****, Mirditë, z. P. B. (P. D.); 6. Denoncim i datës 19.4.2021, i paraqitur nga shtetasi N. Gj..

⁴⁶ Denoncim i shtetasit Gj. Ç., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 18.12.2017.

⁴⁷ 1. Denoncim i shtetasit A. M., regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 21.12.2020; 2. Denoncim i shtetasit Gj. N. (në cilësinë e avokatit mbrojtës), regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 24.7.2018; 3. Denoncim i Bankës Kombëtare Tregtare, regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 23.2.2021; 4. Denoncim i datës 19.4.2021 i paraqitur nga shtetasi N. Gj.; 5. Denoncim i shtetasit N. Ç. regjistruar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 26.2.2018.

50.3.1. Denoncim i shtetasit Gj. Ç., regjistruar pranë Komisionit me nr. * prot., datë 18.12.2017,** i cili ka denoncuar subjektin e rivlerësimit se nëpërmjet vendimmarrjes së tij krejtësisht të pabazuar në ligj dhe në prova, ka treguar paaftësi profesionale, u ka mohuar të drejtën ligjore në lidhje me zgjidhjen e çështjes për kthimin dhe kompensimin e pronave të tij dhe trashëgimtarëve të tjerë të familjes Ç.. Konkretisht, denoncuesi është ankuar për vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit, pas detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 9.9.2015. Si përfundim, denoncuesi ka kërkuar të verifikohet ankesa si dhe ka bashkëlidhur dokumentacionin ligjor mbështetës⁴⁸.

50.3.2. Komisioni ka administruar dokumentacionin e paraqitur nga denoncuesi, nga i cili kanë rezultuar këto rrethana çështjeje: shtetasi Gj. Ç. ka vërtetuar nëpërmjet gjykatës faktin juridik të pronësisë mbi një sipërfaqe toke prej 165 500 m² të trashëgimlënësit⁴⁹ të tij në fshatin *****, të disponuar përpara reformës agrare të vitit 1946. Në vijim ky shtetas dhe trashëgimtarët e tjerë kanë kërkuar kthimin dhe kompensimin e pronave, ku me vendimin nr. ***, datë 26.4.2013, AKKP-ja ka vendosur rrëzimin e kërkesës për njohjen e së drejtës së pronësisë së paraqitur nga trashëgimtarët Ç. mbi pronën e tyre. Vendimin e AKKP-së e kanë ankimuar para gjykatës kompetente, ku në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin me nr. ***, datë 6.11.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; anulimin e vendimit të AKKP-së; njohjen e të drejtës së pronësisë dhe kthimin e pronës subjektit të shpronësuar, duke përcaktuar sipërfaqën që i njihet, etj. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 9.9.2015 ka vendosur prishjen e vendimit me nr. ***, datë 6.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me një tjetër trup gjykues, duke përcaktuar disa detyra për zbatim nga gjykata e rrethit gjatë rishqyrtimit. Në zbatim të këtij vendimi, çështja është rikthyer në gjykatën e rrethit, ku për shqyrtimin e saj është caktuar subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit, pas përfundimit të shqyrtimit, me vendimin me nr. ***, datë 21.4.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka vendosur rrëzimin e padisë etj.

50.3.3. Komisioni analizoi vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit në kuptim të *indicieve* të marra nga denoncimi, nga ku konstatoi se subjekti i rivlerësimit gjatë rishqyrtimit të çështjes i) nuk kishte kryer veprimet procedurale të caktuara nga Gjykata e Apelit Shkodër, të cilat do të mund të qartësonin rrethanat në drejtim të një vendimmarrjeje të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në këtë kuptim, Komisioni vëren të cituar në vendim se: “Gjykata zbatoi detyrat e përcaktuara nga Gjykata e Apelit Shkodër në vendimin civil nr. ***, duke caktuar dhe thirrur një grup të përbërë nga dy ekspertë dhe marrë prova të tjera shpresore të parashtruara nga pala paditëse”, por nga analizimi i vendimit ii) nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të kishte caktuar ekspertë, me qëllim sqarimin e disa çështjeve të paqarta të ngritura nga Gjykata e Apelit Shkodër; iii) nuk rezultoi të jetë hartuar një aktekspertimi, i cili do të mund t’i nënshtrohej hetimit gjyqësor bashkë me provat e tjera; iv) rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arsyetuar qartësisht vendimin, si dhe nuk ka respektuar strukturën e tij sipas nenit 310 të K.Pr.C. Në vendimin e marrë nga subjekti mungon lidhja mes pjesës hyrëse, arsyetuese –përshkruese dhe dispozitivit në fund; v) nuk rezultoi që subjekti të ketë kryer një analizë ligjore të veprimeve

⁴⁸ Pasaportë e denoncuesit Gj. Ç., shkresë me nr. *** prot., datë 4.6.2014 të Arkivit Qendror Shtetëror me lëndë “Përgjigje për të dhëna pronësie në emër të Gj. C. bashkë me dokumentacion bashkëlidhur” (gjithsej 4 fletë); vendim me nr. ***, datë 15. 6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (gjithsej 4 fletë) për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë së të ndjerit gjyshit të tij; vendim me nr. ***, datë 6.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (gjithsej 11 fletë) për anulimin e vendimit të AKKP-së dhe njohjen e të drejtës së pronësisë; vendim me nr. ***, datë 9.9.2015 të Gjykatës së Apelit Shkodër (gjithsej 21 fletë), sipas të cilit është vendosur prishja e vendimit të Gjykatës së Rrethit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim; vendim me nr. ***, datë 21.4.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (gjithsej 4 fletë) sipas të cilit është vendosur rrëzimi i padisë.

⁴⁹ Emri i të ndjerit referohet në denoncim.

të marra në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit; vi) nuk identifikohet se cilave dispozita ligjore u ishte referuar në vendimin e marrë për zgjidhjen e çështjes.

50.3.4. Mbi bazën e këtyre gjetjeve, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në lidhje me vendimin nr. ***, datë 21.4.2016, nga analizimi i të cilit rezultoi se subjekti:

- a) nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 9.9.2015;
- b) nuk ka zbatuar standardin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor. Subjekti nuk ka mbajtur një strukturë të caktuar në vendimin e marrë referuar nenit 310 të K.Pr.C, me qëllim që vendimi të jetë i qartë për palët, i arsyetuar plotësisht në përputhje me kërkesat ligjore gjatë rishqyrtimit nga gjykata e rrethit, si dhe të ketë zgjidhur të gjitha pretendimet e palëve.

50.3.5. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se:

- a. *gjykata ka caktuar ekspertët N. M. dhe H. D., opinioni i ekspertëve u është komunikuar palëve dhe është administruar si provë në gjykim;*
- b. *po ashtu, gjykata ka marrë prova shtesë shkresore të parashtruara nga palët gjatë gjykimit sipas orientimit të vendimit të Gjykatës së Apelit;*
- c. *në përfundim të gjykimit palët janë ftuar për prova të tjera dhe nuk kanë kërkuar marrje provash të tjera;*
- d. *duke qenë se është pranuar dhe marrë prova me ekspert, janë marrë provat shtesë të parashtruara nga palët, këtyre të fundit u është dhënë mundësia të parashtrajnë prova të tjera, vlerëson se ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit;*
- e. *opinionin e ekspertëve nuk është trajtuar në vendimin përfundimtar, sepse nuk ka shërbyer për Gjykatën në nxjerrjen e konkluzioneve.*

50.3.6. Subjekti paraqiti në cilësinë e provës procesverbalin e seancave gjyqësore të nxjerrë i nxjerrë nga sistemi elektronik ICMIS, në lidhje me çështjen me nr. *****, me palë ndërgjygjëse A. Ç. etj., kundër AKKP-së me objekt: “Konstatimin e pavlefshëm të vendimit nr. ***, datë 24.04.2013 të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë. Detyrimin e palës së paditur për njohjen e të drejtës së pronësisë së subjektit të shpronësuar Gj. P. Ç. për pasurinë e paluajtshme ndodhur në Komunën Shëngjin, Mali i *****, zona kadastrale **** dhe Mali i ****, zona kadastrale ****.”

Vlerësimi i Komisionit

50.4. Komisioni administroi procesverbalin e seancave gjyqësore të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, nga ku konstatohet se për shqyrtimin e kësaj çështjeje janë zhvilluar 10 seanca gjyqësore, si dhe seanca e fundit e shpalljes së vendimit. Subjekti, për shqyrtimin e kësaj çështjeje ka caktuar dy ekspertë topografë, ka thirrur palët për të paraqitur pretendimet gjyqësore si dhe prova nëse kanë, ka administruar provat e paraqitura nga palët dhe opinionin e ekspertëve dhe në fund i ka thirrur palët për të paraqitur konkluzionet përfundimtare. Pra, pas kryerjes së këtyre veprimeve procedurale, subjekti ka disponuar me vendim rrëzimi të padisë së paraqitur nga familjarët Ç.. Përtej veprimeve procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se në vendimin me nr. *****, datë 21.4.2016 të dhënë nga subjekti i rivlerësimit ka pasur elemente, të cilat e kanë cenuar vendimin në drejtim të plotësisë dhe qartësisë së tij, për sa subjekti: i) nuk ka arsyetuar plotësisht vendimin e tij në lidhje me bazueshmërinë e vendimmarrjes; ii) nuk ka arsyetuar se përse opinionin e ekspertëve nuk u vlerësua me vlerë për gjykatën në marrjen e vendimit; iii) nuk ka përmendur se në cilat prova është bazuar në marrjen e vendimit përfundimtar; (iv) mungon baza ligjore se pse vendimi i gjykatës për “vleftësimin” e vendimit me nr. 650/2013 të marrë nga AKKP-ja është i drejtë.

50.4.1. Komisioni vlerëson se elementet e konstatuara në këtë vendim mund të bëhen objekt verifikimi në kuadër të vlerësimeve periodike të veprimtarisë profesionale të subjektit të

rivlerësimit apo nëse mund të përbëjnë shkelje disiplinore, por nuk janë të tilla që, ndaj subjektit të zbatohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, në kuptim të pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Fakte mediatike

51. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar edhe disa fakte të njohura publike në mediat e shkruara⁵⁰ ndaj subjektit të rivlerësimit në lidhje me lirimin nga burgu i ish-kryetarit të Komunës *****, Mirditë, z. P. B..

51.1. Nga ky burim prove, është referuar ndër të tjera se subjekti i rivlerësimit liron nga burgu ish-kryetarin e Komunës Kaçinar 12 ditë pasi ishte arrestuar, akuzuar për trafik të lëndëve narkotike.

51.2. Duke i vlerësuar këto fakte si *indicie*, Komisioni ka kryer hetim⁵¹ në lidhje me këtë çështje.

51.3. Nga administrimi i dosjes gjyqësore kanë rezultuar këto fakte:

- i. në datën 22.10.2015, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, në ngarkim të P. D.⁵², vëllait të tij F. D. dhe një shtetasi tjetër i quajtur S. B.. Prokurori i çështjes, pas kryerjes së veprimeve të para hetimore, në vlerësim të kushteve për caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit P. D., sipas nenit 238 të K.Pr.Penale i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”;
- ii. me vendimin nr. *****, datë 28.10.2015, subjekti i rivlerësimit, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 të K.Pr.Penale për të dyshuarin P. D., në mungesën e tij;
- iii. më tej ka rezultuar se pas rreth tre muajsh në datën 5.2.2016 është kryer ekzekutimi i masës arrest në burg në ngarkim të të arrestuarit. Subjekti i rivlerësimit, si gjyqtari i hetimit paraprak, ka proceduar, brenda afatit 3-ditor, sipas nenit 248 të K.Pr.Penale, me marrjen në pyetje të shtetasit D. ndaj të cilit, me vendimin nr. ***, datë 8.2.2016 subjekti i rivlerësimit, ka vendosur të vijojë masa e sigurimit “Arrest në burg” ndaj të arrestuarit D.;
- iv. në vijim, i arrestuari D. ka kërkuar nëpërmjet përfaqësuesit të tij, në datën 11.2.2016 (regjistruar në gjykatë me nr. ***** akti në këtë datë), zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” me masën “Arrest në shtëpi”, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore. Në këtë kërkesë, mbrojtësi ka parashtruar se nuk ka asnjë provë në ngarkim të të arrestuarit për kryerjen e veprës penale dhe se ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore, nga qëndrimi i të cilit në burg do t’i shkaktoheshin pasoja të parikuperueshme;
- v. me vendimin nr. *****, datë 18.2.2016, subjekti i rivlerësimit, pasi ka arsyetuar ndër të tjera, se ka kaluar kohë e mjaftueshme (tre muaj hetime) për të vërtetuar dyshimet ndaj të arrestuarit dhe prokuroria nuk ka vërtetuar që ka baza të justifikuara për vijimin e zbatimit të masës arrest me burg si dhe referuar gjendjes së rëndë shëndetësore të vërtetuar nga mjeku i IEVP-së Shënkoll, ekzaminimeve mjekësore të kryera përpara arrestimit, prej ku rezulton se ai vuan nga *Asthma bronchialis* me kriza të shpeshta, *Diabet Mellitus tip II* dhe *Dislipidemia et HTA stadi II*, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit D., duke zëvendësuar masën e sigurimit “Arrest në burg” me masën e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore” parashikuar në nenin 234 të K.Pr.Penale, duke urdhëruar

⁵⁰ <https://www.balkanweb.com/site/kryekomunari-kauboj-i-ps-lirohet-nga-burgu-sepse-gerhiste/>.

⁵¹ Me shkresën me nr. ***** prot., datë 18.3.2021 dhe kthim përgjigjeje nr. ***** prot., datë 30.3.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

⁵² Nga administrimi i dosjes gjyqësore i ashtquajtur i P. B. mban gjeneralitetet P. D..

të arrestuarin të paraqitet në seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë ditën e martë të çdo jave, ora 13.00;

- vi. pas ankimit të prokurorit të çështjes, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 16.3.2016 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 18.2.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

51.4. Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me disa problematika që rezultuan në këtë çështje si:

i) subjekti ka shqyrtuar kërkesën e datës 11.2.2016 për zëvendësimin e masës, në tejkalim të afatit 5-ditor, përcaktuar në nenin 260 pika 4⁵³ të K.Pr.Penale;

ii) nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë arsyetuar vendimin për zëvendësimin e masës me arrest shtëpie, me shkakun e gjendjes së rëndë shëndetësore të të arrestuarit, pasi referuar rekomandimit të mjekut të IEVP-së i arrestuari ishte vendosur në ambientet e infermierisë së institucionit për t'u pasur nën kontroll nga stafi mjekësor, pasi ambienti ku ndodhej e acaronte më tepër gjendjen e tij shëndetësore;

iii) nuk rezulton që subjekti të ketë arsyetuar vendosjen e masës "Detyrim për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore" në raport me atë të kërkuar nga i arrestuari "Arrest në shtëpi", e për rrjedhojë rezulton se ka tejkaluar objektin e kërimit.

51.5. Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjekti shpjegoi se: *"Gjykimi ka përfunduar nëpërmjet 3 seancave dhe në tejkalim të afatit 5 ditë të parashikuar në nenin 260/4 të KPP, për arsye se një seancë nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së kërkuarit dhe përfaqësuesit të zgjedhur, si dhe mosmarrjes dijeni prej këtij të fundit, seanca tjetër nuk është zhvilluar për arsye familjare të mbrojtësit të kërkuarit -seancat janë caktuar në ditë afër njëra-tjetrës, për të mos shkaktuar shtyrje të gjata;kërkesa e kërkuarit është bazuar në dy arsye; a) provat ndaj tij b)gjendja shëndetësore; të dyja arsyet ku ka bazuar kërkesën kërkuari janë trajtuar dhe vlerësuar nga unë në vendimin përkatës; masa e sigurimit e caktuar ka qënë më e lehtë se ajo e kërkuar nga kërkuari, sepse dhe graviteti i provave në ngarkim të kërkuarit ka qënë i tillë që nuk justifikonte caktimin dhe mbajtjen në fuqi të masës së sigurimit arrest në shtëpi të kërkuar prej tij."* Subjekti paraqiti si provë procesverbalin e nxjerrë nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore si dhe një kërkesë të kërkuarit P. D.

Vlerësimi i Komisionit

51.6. Komisioni, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit, si dhe ato të paraqitura në seancën dëgjimore të datës 21.4.2021 çmon se ato nuk janë bindëse. Në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e masës, përtej afatit ligjor 5-ditor, referuar nenit 260/4 të K.Pr.Penale, e cila sipas subjektit ka ndodhur për shkaqe ligjore, Komisioni e konsideron të pabazuar shpjegimin e subjektit. Komisioni arrin në këtë konkluzion për arsye se kjo dispozitë përfaqëson një normë detyruese për t'u zbatuar brenda afatit të shkurtër, për shkak të natyrës së ngutshme që kanë kërkesat për revokimin/zëvendësimin e masës së sigurimit personal, në kuptim të nenit 260 të K.Pr.Penale.

51.7. Në lidhje me bazueshmërinë e vendimit për zëvendësimin e masës, Komisioni vlerëson se, pa analizuar logjikën e gjyqtarit, por vetëm duke u bazuar në arsyetimin e tij në vendimin e dhënë, subjekti nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm se cilat kanë qënë arsyet, në të cilat është bazuar vendimi i zëvendësimit të masës me burgim me një masë tjetër më të lehtë. Rezultoni

⁵³ Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokim ose zëvendësimin e masës shqyrtohet nga gjykata brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj.

nga faktet se kushtet shëndetësore nuk i krijojnë të pandehurit pamundësi të qëndrimit në burg, pasi ai mbikëqyret nga infermieret e burgut, referuar rekomandimit të mjekut të IEVP-së. Gjithashtu në çmim të Komisionit nuk rezultojnë të ketë patur gravitet provash, sikundër është shprehur subjekti, graviteti i cili mund të ndryshonte kushtet e masës në një kohë shumë të afërt, për arsye se vetë subjekti para vetëm 10 ditëve nga vendimi për zëvendësimin e masës, bazuar në nenin 248 të K.Pr.Penale “Marrja në pyetje e personit të arrestuar” ka vendosur me vendimin **, datë 8.2.2016 vijimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”.

51.8. Në këtë konkluzion, Komisioni arrin duke pasur parasysh se subjekti në zbatim të nenit 248 të K.Pr. Penale, përpara se të dispononte për vijimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, ka verifikuar kushtet dhe nevojat e sigurimit dhe në përfundim ka vendosur se i pandehuri duhet të qëndrojë në burg. Nëse kushtet do të kishin ndryshuar, subjekti do të kishte disponuar në një masë më të lehtë në zbatim të nenit 248⁵⁴, paragrafi i dytë. Nuk u gjetën arsye bindëse nga subjekti dhe as prova të reja të administruara nga ai, që të mund të provonin ndryshimin e kushteve në një kohë shumë të afërt, për 10 ditë, e për pasojë të diktonin nevojën për ndryshimin e masës, duke e zëvendësuar atë me një masë më të lehtë.

51.9. Komisioni çmon se këto gjetje, gjithsesi, nuk janë proporcionale për të zbatuar masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, por mund të bëhen objekt verifikimi i mëtejshëm në kuadër të vlerësimeve periodike, në lidhje me veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit ose nëse mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin profesional

60. Si konkluzion, Komisioni vlerësoi se gjetjet e trajtuara më lart nuk janë të mjaftueshme për ta kualifikuar subjektin e rivlerësimit si “me mangësi” apo “i papërshtatshëm”, në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, në kuptim të germave “b” dhe “c”, të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, ka njohuri ligjore procedurale dhe materiale, identifikon normën në zgjidhjen e konfliktit, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Gjithashtu, çështjet e përmendura nuk përbëjnë shkak që mund ta çonin trupin gjykues në përfundimin se subjekti i vlerësimit ka cenuar besimin e publikut në dhënien e drejtësisë, në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

61. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi vlerësoi çështjen në tërësi, bazuar në provat e administruara, si dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Përdeda:

a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;

b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;

c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

d. Në lidhje me çështjen administrativo-civile nr. *****, të shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për të cilin është dhënë vendimi nr. ***, datë 21.4.2016, si dhe në lidhje me çështjen penale, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 18.2.2016, mbi ndryshimin e masës së sigurisë personale ndaj shtetasit P. D., që i përket procedimit penal nr. ***, datë

⁵⁴ Neni 248. “Marrja në pyetje e personit të arrestuar”.

Kur këto kushte nuk ekzistojnë, gjykata vendos revokimin ose zëvendësimin e masës. Në të kundërt, gjykata vendos vazhdimin e zbatimit të saj.

22.10.2015, për veprën penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, në bashkëpunim, të shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, trupi gjykues vlerëson se në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, këto çështje duhet të transferohen pranë organit kompetent për inspektim, nëse verifikohen shkaqe që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, si dhe referuar pikës 1, germa “a” të nenit 58, pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ilir Përdeda, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.
2. Bazuar në pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, transferimin pranë organit kompetent, për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, të dosjeve si më poshtë:
 - a) çështja civile nr. *****, e shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për të cilin është dhënë vendimi nr. ***, datë 21.4.2016;
 - b) vendimi nr. ***, datë 18.2.2016, mbi ndryshimin e masës së sigurisë personale ndaj shtetasit Petro Doda, që i përket procedimit penal nr. ***, datë 22.10.2015, për veprën penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, në bashkëpunim, të shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.
3. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016;
4. Ndaj këtij vendimi, me përjashtim të pikës 2, mund të ushtrohet ankim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose nga Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 23.4.2021

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim Hamitaj

Kryesues

Genta Tafa (Bungo)

Anëtare

Pamela Qirko

Relatore

Ertugena Sokoli
Sekretare gjyqësore

ANEKSI 1-ANALIZA FINANCIARE PËRMBLEDHËSE

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) PASURI	500,000	0	500,003	705,775	694,316	828,540	657,893	697,669	914,576	773,567	439,502	985,150	513,700	-174,211
Apartament banimi me sipërfaqe 83 m2, i ndodhur në **** të qytetit R***, sh. ** ap. **, me numër pasurie *****, zona kadastrale ***, vol **, faqe **, indeks harte ****, i blerë nëpërmjet privatizimit nga ish Ndërmarrja Komunale Banesa Mirditë me datën 12.5.1993, sipas kontratës së shitjes nr.*** të Zyrës së Notarisë Mirditë, blerë nga babai N. P., me cilësimin e përfaqësuesit të familjes, duke patur si burim të ardhurat nga pensioni i tij dhe paga e nënës së deklarames it. Vlera është 17.666 lekë. Zotëron 33.33%.														
Ndryshim likuiditeti	500,000	0	500,003	705,775	694,316	828,540	657,893	697,669	914,576	773,567	439,502	985,150	513,700	-174,211
TOTAL LIKUIDITETE	500,000	500,000	1,000,003	1,705,778	2,400,094	3,228,634	3,886,527	4,584,196	5,498,772	6,272,339	6,711,841	7,696,991	8,210,691	8,036,480
B) DE TYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
C) PASURI NETO A-B	500,000	0	500,003	705,775	694,316	828,540	657,893	697,669	914,576	773,567	439,502	985,150	513,700	-174,211
D) TË ARDHURA	1,098,117	1,642,037	1,656,730	1,536,524	1,686,850	1,784,151	1,901,128	2,202,884	2,130,774	2,405,859	2,189,361	2,641,061	2,657,793	3,751,815
Të ardhura nga paga subjekti Ilir Perdeda	718,117	982,037	1,006,730	1,006,524	1,019,368	902,925	913,314	1,064,929	855,102	1,060,710	1,108,399	1,411,340	1,449,132	1,447,457
Të ardhura nga aktiviteti Farmaci, në emër të D. L. me NIPT ***** e regjistruar në dt. 1.1.2003, sipas vendim nr. **, dt. 20.2.2000, nga Gjykata e rrethit Mirditë për regjistrimin Person Fizik të D. L., për ushtrimin e aktivitetit tregim të barnave farmaceutike.	380,000	660,000	650,000	530,000	667,482	804,517	871,174	823,483	960,588	917,603	659,735	977,110	1,194,307	1,498,141
Të ardhura nga paga si farmacistë personi i lidhur D. L. (kredituar në bankë)								144,372	146,334	267,810	228,312	230,212	-	763,408
Të ardhura nga interesat e depozitës pranë Raiffeisen Bank						76,709	116,640	170,100	168,750	159,736	192,915	22,399	14,354	42,809
E) SHPENZIME	332,348	565,584	753,179	328,671	471,860	505,860	658,860	822,517	832,456	531,647	770,114	1,150,538	1,195,711	821,276
Shpenzime jetike	281,592	281,592	328,671	328,671	409,860	409,860	409,860	409,860	409,860	423,072	423,072	659,994	672,828	705,276
Shpenzime udhëtimi (Rubik-Lechë-R***)					32,000	96,000	96,000	96,000	96,000	96,000	96,000	96,000	96,000	96,000
Shpenzime udhëtimi	6,764		24,508					16,657	16,596	12,575		56,044	6,883	
Shpenzime mobilimi / mirmbajtje apartamenti në R***		240,000	100,000		30,000		93,000		110,000		133,000	186,000		
Shpenzime qira ambjentit (Farmaci)	43,992	43,992	300,000				60,000	300,000	200,000				400,000	
Shpenzime mjeksore											118,042	152,500	20,000	20,000
D) Analiza financiare (D-C-E)	265,770	1,076,453	403,548	502,078	520,674	449,751	584,375	682,698	383,742	1,100,645	979,745	505,374	948,382	3,104,750